



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:290004

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05681283

A.nr.3071/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, D.K. nga fshati ... komuna e, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson ... avokat, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë- Departamenti i Pensioneve, me bazë juridike “anulimi i vendimit dhe njohja e të drejtës për pensionin për persona me aftësi të kufizuara si dhe kompensimi”, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të paditurës, më datën 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit, ... nga fshati

II. ANULOHEN vendimet e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Departamenti i Pensioneve, me numër të dosjes 6035484, i datës 20.01.2022 dhe vendimi i shkallës së parë i datës 09.08.2021, si dhe paditësit i njihet e drejta në Pensionin për Persona me Aftësi të Kufizuara, në kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe atë nga data e nxjerrjes së vendimit datë 16.04.2024 e deri me 16.04.2029.

III. DETYROHET e paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Departamenti i Pensioneve, që paditësit në mënyrë retroaktive t’ia kompensoj pagesat për Pensionin për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe atë data e ndërprerjes – kërkesës së këtij pensioni datë 12.05.2021 e deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi datë 16.04.2024, në shumën mujore nga 75 (shtatëdhjetë e pesë) euro për periudhën maj 2021-dhjetor 2021, ndërsa në shumën mujore prej 100 (njëqind) euro për periudhën nga janari 2022, e krejt këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nën pasojat e përmbarimit me detyrim.

IV. UDHËZOHET paditësi që para datës 16.04.2029 të paraqesë kërkesë për rivlerësim mjekësor tek e paditura, për t’i vazhduar njohjen e kësaj të drejtë.

V. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 23.12.2021, ka parashtruar padi, dhe gjykata për të shqyrtuar të njëjtën ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, e cila është mbajtur me datë 16.04.2024, konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prezencën të autorizuarit palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, e ftuar në mënyrë të rregullt.

Kështu i autorizuari i paditësit, në seancën e shqyrtimit kryesor ka qëndruar në tërësi si në padinë e parashtruar dhe plotësimit dhe precizimit të padis para kësaj gjykate, duke i kërkuar gjykatës, që të aprovohet kërkesëpadija si e bazuar ashtu që kërkon nga gjykata që të anulon aktvendimin me numër 6035484 të datës 12.05.2021 si dhe aktvendimin me numër 6035484 të datës 20.01.2022, të paditurës. Sa i përket plotësimit të ekspertizës të njëjtën e kemi pranuar në kohë dhe konsiderojmë që është përpiluar në mënyrë profesionale nga grupi i eksperteve dhe nuk le vend për paqartësi. Në fund thekson se, kërkon që paditësit ti njihet e drejta në pensionin me aftësi të kufizuar nga data 12.05.2021 e deri në nxjerrjen e këtij vendimi dhe pas kësaj date ti njihet edhe për 5 vitet e ardhshme.

E paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Departamenti i Pensioneve, përmes Avokaturës Shtetërore nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor, ndërsa nëpërmes përgjigjes së dhënë në padi me datë 06.06.2023, ka theksuar se, vendimi i atakuar është i bazuar dhe pretendimet e palës paditëse për shkëlqje ligjore nuk qëndrojnë, për arsye se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi, ashtu që pretendimet e veta pala paditëse nuk i ka vërtetuar me asnjë provë. Mbi këto arsye i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit në tërësi si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin kontestues të paditurës.

Ekspertet mjekësor Dr. ... në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet pran plotësimit të ekspertizës, të cilën ia kemi dorëzuar gjykatës me datë 19.02.2024, ashtu që kemi konstatuar që pacienti ... është person me aftësi të kufizuar, pasi që tek në njëjtë ekziston zvogëlimi i aktivitetit jetësor fizik dhe psikik. Në fund thekson se, kanë konstatuar se kanë pjesë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor datës 16.04.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë është administruar: vendimi i dt.20.08.2021; librezja e dt.16.09.2021; fletë lëshimi i dt.22.05.2014; i dt.11.09.2014; fletë lëshimi i dt.18.04.2014; fletë lëshimi i dt.11.09.2014; 08.04.2022; raporti mjekësor i dt.13.09.2021; raporti specialistik i dt.14.09.2021; raporti i dt.15.12.2014; fletë përcjellësi i dt.12.05.2014; raporti nga konsulta 14.09.2021; raporti i dt.16.09.2021; raporti i dt.16.03.2023; i

dt.15.09.2022; i dt.16.09.2022, i dt.15.09.2022; raporti 10.07.2023; raporti nga konsulta i dt.03.08.2023; vendimi i dt.20.01.2022; ankesa e dt.16.09.2021; vendimi i dt.20.08.2021; Raporti i dt.16.09.2021; i dt.14.09.2021; vlerësimi – konstatimi i komisionit mjekësor 09.06.2021; Shqyrtimi i ankesave 23.10.2021; Konstatimi 09.08.2021; raporti i dt. 11.05.2021; Ekspertiza e dt.13.11.2023 dhe Plotësimi i ekspertizës te dt.19.02.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative ashtu që vendosi që vetë meritorisht ta vendosë këtë çështje administrative. Gjykata duke vlerësuar e vendimin e goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve të padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar

Nga vendimi i kontestuar del se, ai përmban të meta të tilla, për shkak të cilave, nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 paragrafi 1 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Ndërsa në nenin 48 paragrafi 2 të po të njëjtit ligj është përcaktuar që, një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit kontestues është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: Këshilli i ankesave si organ i shkallës së dytë me ekspert mjekësor të lëmisë përkatëse duke vepruar sipas ankesës së z. ... nga fshati ..., komuna e ..., ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e datës 23.11.2021, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e komisionit të shkallës të parë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 të Ligjit për PAK dhe ka konstatuar se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfitues i pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, prandaj komisioni mjekësor i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj”. Prandaj nga një formulim i tillë i arsyetimit gjykata nuk mund të kuptoj se çfarë ka konstatuar e paditura nga dokumentacioni i shqyrtuar lidhur me paaftësinë e aplikuesit të pensionit, në këtë rast paditësit.

Gjykata nga shkresat e lëndës ka vërejtur se me vendimin e të paditurës të datës 20.01.2022, me numër të dosjes 6035484, refuzohet ankesa e paditësit për njohjen e të drejtës në pensionin me pa aftësi të përhershme si të pa bazuar me arsyetimin se nuk i ka plotësuar kushtet ligjore.

Gjykata në të mirë të konstatimit të gjendjes faktik me aktvendimin A.nr.3071/2021 të datës 04.09.2023, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizës mjekësore e cila i është besuar ekspertëve mjekësor të certifikuar nga KGJK-ja , si dr. ... – Psikiatër, dr. ...- Ortoped dr.– Interniste.

Të njëjtit ekspert mjekësor kanë përpiluar Ekspertizën me datën 13.11.2023, dhe plotësimin e ekspertizës të datës 19.02.2024, ku në bazë të saj këta ekspertet, pas ekzaminimit të shkresave të lëndës dhe ekzaminimit direkt të pacientit, kanë konkluduar se pacienti pacienti ... është person me aftësi të kufizuar, pasi që tek i njëjti ekziston zvogelimi i aktivitetit jetësor fizik dhe psikik andaj bënë pjesë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata, pasi që vlerësoj secilën provë veç e veç dhe të gjitha në lidhmëni me njëra tjetrën gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Në veçanti gjykata krijoi bindjen e saj nga ekspertiza dhe plotësimi i saj e nxjerrë nga grupi i ekspertëve mjekësorë të lartcekur, të cilët kanë konstatuar se të paditësi ekziston paaftësia dhe e njëjta është e plotë dhe e përhershme për punë.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar si provë edhe vlerësimin e Komisionit mjekësorë të paditurës, të datës 09.08.2021 dhe atij të datës 23.11.2021, mirëpo duke qenë se të njëjtat nuk përmbajnë kurrfarë sqarime dhe arsyetime lidhur me gjendjen shëndetësore të paditësit dhe nëse e njëjta ka ndryshuar mbi çfarë baze është vërtetuar se ka ndryshuar, ndërsa në anën tjetër nga shkresat e tjera të lëndës vërtetohet se gjendja e tij nuk ka ndryshuar dhe këtë fakt e vërtetoi edhe ekspertiza mjekësore e nxjerr në procedurë gjyqësor, nga të gjitha këto arsye gjykata nuk mundi ti fal besimin vlerësimit dhe konstatimit të Komisionit Mjekësor të të paditurës, si provë e vetme sipas të cilit paaftësia e përhershme e kufizuar të paditësi nuk ekziston.

Prandaj, bazuar në provat e lartcekura dhe ekspertizën e datës 13.11.2023 dhe plotësimin e ekspertizës të datës 19.02.2024, në përbërje prej tre (3) profesionisteve të fushave përkatëse, vërtetohet se paditësi është person me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme, dhe për këtë gjykata i'a ka njohur paditësit të drejtën në pension të kësaj kategorie për periudhën si të përcaktuar në paragrafin II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me nenin 9 paragrafi 1 dhe 5 i Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përcaktohet se :“Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim

nga Buxheti i Republikës së Kosovës”. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh;. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nenin paragrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.” Nga kjo rrjedh se e rëndësisë partikulare që një personi ti njihet e drejta në pension të personave pa aftësi të përhershme është që të konstatohet nëse ekziston apo jo paaftësia e përhershme e punës, e që në rastin konkret paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e lartcekura ligjore, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me tej, neni 19 i të njëjtit ligj cili përcakton se, të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimit të kërkesës në Ministri. 2. Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe vendoset në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës. 3. Parashtruesi i kërkesës duhet të njoftohet me shkrim, lidhur me realizmin e të drejtës në pension. 4. Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në organin e shkallës së dytë të Ministrisë. 5. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. 6. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim dhe udhëzon palën për mundësinë e zhvillimit të procedurave të mëtuftjeshme gjyqësore. 7. Pala e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së dytë, me padi, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit të vendimit me shkrim, mund të hap konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.

Ndërsa me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ është paraparë që “Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”. Po ashtu e paditura me vendimin e atakuar 20.08.2021 dhe vendimin e datës 20.01.2022, i’a ka mohuar paditësit të drejtën për shfrytëzimin e pensionit me paaftësi të përhershme. Nga kjo rezulton se paditësi në momentin e ekzekutimit të vendimit të të paditurës i është shkaktuar dëm ngase i njëjti nuk ka mundur të realizoj të ardhurat që kanë buruar nga e drejta në shfrytëzimin e pensionit të personave me paaftësi të përhershme, andaj gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata sa i përket lartësisë së pensionit ka marr për bazë edhe vendimin e Qeverisë 01/176 të datës 10.03.2014, si dhe vendimin e Qeverisë 05/54 të datës 12.01.2022.

Prandaj për faktin se paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata kërkesëpadinë e saj e aprovoj si të bazuar dhe si rrjedhojë e detyroj të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi meqë vlerësoj se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të eksperteve, ekspertiza është e çartë, nuk ka kontradiktë në vete si dhe e paditura nuk e ka

kontestuar, nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, madje e paditura nuk i është përgjigjur as ftesave për seancën e shqyrtimit kryesor. Për të gjitha këto arsye kjo gjykatë me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, respektivisht në respektim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt brenda afateve të arsyeshme, nga vlerësimi i përgjithshëm ka krijuar bindje se ekspertiza e nxjerrë nga QKUK, është provë e besueshme e paanshme për të vendosur çështjen.

Kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje se paditësja nuk i ka plotësuar kriteret për njohjen e këtij pensioni mirëpo si të tilla kjo gjykatë pasi i vlerësoj i refuzoj si të pabazuara pasi nuk i pa me ndikim në një vendimmarrje tjetër nga vërtetimi dhe vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë vlerësoj dhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, mirëpo të njëjtat i vlerëson si të pabazuara, nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është vërtetuar se paditësi i plotëson kërkesat e ligjit për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të nenit 46.5 lidhur me nenet 5, 6, 38 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 9 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.3071/2021- datë 16.04.2024

G j y q t a r j a

Luljeta Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.